



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument Parlamentar

RAPORT

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSPEKTORIATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESIT PËR VITIN 2017

Komisioni Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e zhvilluar në datë 12 korrik 2018, mori në shqyrtim raportin vjetor të performancës së Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit, Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (këtu e në vijim ILDKPKI) për vitin 2017. Ky raport u prezantua dhe shqyrtua në zbatim të detyrimit ligjor të përcaktuar në nenin 39 të Ligjit Nr. 9049/2003 “*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë*”, i ndryshuar si dhe nenit 103 të Rregullores së Kuvendit .

Inspektorati i Lartë nëpërmjet Raportit, bën të njohur aktivitetin institucional gjatë vitit 2017 për zbatimin e kuadrit të zgjeruar ligjor të tij, masat konkrete të marra në funksion të parandalimit dhe luftës kundër korrupsionit, përmbushjen e kërkesave dhe rekomandimeve ndërkombëtare, rishikimin ligjor, bashkëpunimin ndër-institucional me institucionet e tjera ligjzbatuese dhe organizmat ndërkombëtarë që e asistojnë, transparencën e realizuar me median.

Në seancën dëgjimore, Inspektori i Përgjithshëm, Z.Shkëlqim Ganaj prezantoi fokusin dhe arritjet kryesore të aktivitetit institucional për vitin 2017 me zbatimin e të gjithë kuadrit ligjor, konkretisht 4 ligjeve:

Ligji nr. 84/2016, “*Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”; Ligji nr. 9049/2003 “*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë*”, i ndryshuar me ligjin 42/2017, Ligji nr. 9367/2005 “*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*”, i ndryshuar, Ligji nr. 60/2016 “*Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve*”

Prioritet i punës së Inspektoriatit të Lartë gjatë vitit 2017, ka qenë zbatimi i kompetencave të shtuara në Kushtetutën e amenduar dhe ligjin 84/2016 për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Për këtë, Inspektorati i Lartë është angazhuar maksimalisht për garantimin e mbarëvajtjes të të gjithë procesit duke vendosur marrëdhënie institucionale me organet e rivlerësimit dhe me Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit dhe dorëzuar brenda afateve të përcaktuara ligjore raportet e hollësishme dhe të arsyetuara për subjektet e procesit të rivlerësimit të përfshirë në listën prioritare. Puna e ILDKPKI si organ ndihmës për procesin e rivlerësimit kalimtar ka dhënë dhe indikatorët e parë të rezultateve të vendimarrjes së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit i ngritur në

funksion të ligjit 84/2016, i cili në kriterin e parë të rivlerësimit të subjektit, vlerëson pasurinë e tij duke u bazuar, ndër të tjera, edhe në raportin e arsyetuar të ILDKPKI

Inspektoriati I Lartë ka marrë gjithashtu të gjitha masat e nevojshme institucionale në ushtrim të kompetencës së re ligjore në zbatim të ligjit nr. 60/2016, datë 2.6.2016 *“Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”* me ngritjen dhe funksionimin e 163 njësive përgjegjëse në sektorin publik dhe 446 në sektorin privat si dhe aplikimin e të gjithë instrumenteve dhe kompetencave ligjore duke raportuar treguesit e parë lidhur me zbatimin e këtij ligji.

Pavarësisht fluksit të lartë të deklaratave të rregjistruara, më tej përpunuara dhe kontrolluara sipas listës prioritare për subjektet e rivlerësimit kalimtar, ndërkohë ILDKPKI ka vijuar punën në ushtrim të të gjitha kompetencave ligjore dhe respektimin e afateve ligjore në zbatim të dy ligjeve bazike, atë të deklarimit të pasurisë të ndryshuar me ligjin 42/2017 dhe të konfliktit të interesit. Gjatë vitit 2017, Inspektoriati i Lartë ka marrë masa ndëshkuese, duke aplikuar në total 436 masa administrative ‘gjobë’ dhe ka depozituar 32 referime penale, pranë Institucionit të Prokurorisë, strukturave të hetimit tatimor dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, duke kërkuar në çdo rast dhe marrjen e masave disiplinore nga institucionet ku zyrtarët shkelës të ligjit, kryejnë funksionet publike.

Në diskutimin e ngritur në komision lidhur me akesin e të dhënave direkte në rregjistrat publikë, Inspektori i Përgjithshëm sqaroi se ILDKPKI ka akes të kufizuar në sistemin TIMS apo verifikimet e të dhënave jashtë vendit, gjë të cilën KPK dhe ONM e kanë të pakufizuar.

Ndërkohë me asistencën e USAID dhe projektit të BE-së, do të sigurohet në plan të afërt sistemi elektronik i deklarimit të interesave privatë, si një sistem i cili do të mundësojë mbledhjen në kohë reale të të dhënave/deklarimeve të pasurive dhe burimit të krijimit të tyre nga subjektet e deklarimit, përpunimin e të dhënave në mënyrë elektronike duke evituar procesin manual me kosto të burimeve njerëzore dhe financiare të deritanishme, shkëmbimi elektronik i të dhënave me institucione të tjera si dhe harmonizimi me sistemet gjysëm elektronike të kontrollit arithmetiko-logjik dhe rregjistrin e konfliktit të interesit. Ky sistem elektronik së bashku me publikimin online të deklaratave të pasurisë do të përmbushin edhe rekomandimet e GRECOs si dhe garantojnë zbatimin e ligjit të amenduar për deklarimin dhe kontrollin e pasurive në vitin 2017.

Në mbledhjen e datës 19 korrik 2018, Komisioni diskutoi mbi draft-rezolutën për vlerësimin e veprimtarisë së ILDKPKI për vitin 2017 e cila mban në vëmendje edhe gjetjet dhe rekomandimet e raportit të fundit të Komisionit Europian dhe GRECOs. Opozita nuk ishte e pranishme.

Draft-rezoluta thekson rëndësinë e pavarësisë dhe integritetit të institucionit të ILDKPKI, si organi kyç në luftën antikorrupsion, mbështetjen dhe inkurajimin e këtij institucioni për angazhimin me prioritet të ILDKPKI në lidhje me mbarëvajtjen e proceseve të vetingut, përmbushjes së detyrimeve ligjore për zbulimin e pasurive të paligjshme dhe nxitjen e denoncimit e ndëshkimit të praktikave të pasurimit korruptiv si dhe rastet e konfliktit të interesit.

Në përfundim, Komisioni miratoi tekstin e draft-rezolutës me votat e shumicës të anëtarëve të komisionit, dhe ja përcjell seancës plenare për miratim.

Relator
Adnor SHAMETI

Kryetar
Ulsi MANJA